



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARIAN A. MERKURI  
ADRESA IBRAHIM RUGOVA,  
SHALLVARET  
TEL: 692083646

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 514

Nr. koleksioni: 212

Tirane më 17/03/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050600023973925





A2021050600023973925



**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI  
( TË SHOQËRISË “ESTELITE DENTAL CENTER” SH.P.K)**



Sot, më datë 17.03.2021, para meje Noter ARIAN A. MERKURI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, IBRAHIM RUGOVA, SHALLVARET, u paraqit personalisht:

**SHITES:** Artan Kusi, atësia Hasan, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Myslym Shyri; Nd. 80; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 05/03/1954, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034657890 dhe nr. personal F40305158K, me poshte do te quhet **Shitesi**..

**BLERES:** Arisa Sinanaj, atësia Saimir, amësia Diana, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në TIRANË, me adresë Ymer Kurti; Nd. 13; H. 5; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 09/07/1990, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032138542 dhe nr. personal J05709055W, me poshte do te quhet **Bleresi**.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “ESTELITE DENTAL CENTER” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Te dy palet, bazuar ne vullnetin e plote dhe te lire dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtare dhe shoqerite tregtare” dhe vecanerisht neni 73, pika 1, germa ç dhe pika 2, si dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” hartojme kete kontrate shitje te kuotave te kapitalit ne shoqerine tregtare “ESTELITE DENTAL CENTER” Shpk.

Shitesi: Artan Kusi, me gjeneralitet e mesiperme, zotrues i 50% te kuotave te kapitalit ne shoqerine “ESTELITE DENTAL CENTER” shpk, te regjistruar ne QKB me Nipt L71819004K, ne mbeshtetje te vendimit te organit kompetent te shoqerise dhe pasqyruar edhe vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise “ESTELITE DENTAL CENTER” shpk nr. 21/01 date 11.03.2021, ka vendosur ti shes znj. Arisa Sinanaj (Bidaj) me gjeneralitetet e mesiperme, 50% te kuotave te kapitalit, me vlere totale 25.000 euro, kuota te cilat ky ortak i zoteron ne shoqerine “ESTELITE DENTAL CENTER” shpk. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate z. Artan Kusi nuk do te zoteroje asnje prej kuotave te kapitalit dhe znj. Arisa Sinanaj (Bidaj) do te zoteroj 100% te kuotave te kapitalit ne kete shoqeri.

Bleresi: Znj. Arisa Sinanaj (Bidaj) eshte dakort me kete blerje, e pranon blerjen e mesiperme me vleren 25.000 euro dhe behet pronar i ketyre 50% te kuotave te kapitalit ne shoqerine “ESTELITE DENTAL CENTER” shpk.

**ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se kuotave ne masen 50%(pesedhjetepaqind nga shitesi, do te jete e





A2021050600023973925

barabarte me nje vlere prej 25.000 euro (njezete e pesemije),  
Palët deklarojnë se nga ana e Blerësit është likuiduar vlera monetare e sipërcituar  
Pagesa ne shumen e mësipërme eshte bere jashte zyres noteriale dhe nuk ka asnje lloj pretendimi  
nga palet.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga shuma prej  
50.000 euro, shume e percaktuar ne baze te vullnetit te ortakut te shoqerise.

Ky kapital, sipas ligjit, do ndryshoje dhe do ndahet, ne 1 kuota me vlere nominale prej 50.000 euro  
gjithsej, te cilat jane shlyer tashme per teresine e vleres nominale te saj.

Kuotat jane te numeruara nga 1 deri 1.

Pas kryerjes se ketij transaksioni, ortak i shoqerise eshte:

Arisa Sinanaj (Bidaj), e bija e Sajmirit, e datelindjes 09.07.1990, me leternjoftim me nr 032138542  
dhe me numer personal J05709055W, lindur Tirane e banues ne Tirane, do te zotroj 100% te  
kuotave ose 1 kuote, me vlere 50,000 euro.

#### ANEKSET E KONTRATËS

. Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen  
Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve, datë 11.03.2021, bashkëlidhur
- Ekstrakt i Regjistrisë Tregtar për Shoqërinë
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

. Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të  
qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe  
meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e  
nëshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

. Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta  
përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë  
20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nëshkrimin e tyre.

. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri  
deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë  
të drejtë dhe të ligjshme.

#### PALËT KONTRAKTUESE

SHITESI  
Artan Kusi

BLERESI  
Arisa Sinanaj (Bidaj)

Noter  
ARIAN A. MERKURI

ESTELITE  
DENTAL CENTER SHPK  
NIPT.L71619004K





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71819004K	
2. Data e Regjistrimit	19/06/2017	
3. Emri i Subjektit	ESTELITE DENTAL CENTER	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	28/04/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 28/04/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.10, Rruga Myslym Shyri, apartamenti Nr.3	
8. Kapitali	50.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Nderhyrje Dentare, ne te gjitha kategorite qe diploma e dentistit, dhe rregullorja e urdherit te dentistit shqiptar i jep te drejten ushtrimit te profesionit, si Kirurgji, Endodonci, Ortodonci, Konservativ, Protezike, laborator dentar, estetike fytyre etj.	
10. Administratori/ët	Arisa Bidaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 25/07/2017	Deri: 25/07/2022
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ArtanKusi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 25.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		